



**FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS**  
**KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION**

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë  
Tel: +383-44-170-586 / Email: [info@fppk.com](mailto:info@fppk.com) / ueb: [www.fppk.com](http://www.fppk.com)

---

**RREGULLORE MBI PUNËN E**  
**PËRFAQËSUESES SË KOSOVË**

PRISHTINË 2024

Në bazë të nenit 15 paragrafi 2.1 dhe në përputhje me nenin 26 dhe 27 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Pingpongut, në mbledhjen e mbajtur me datën 14/12/2024 miratoi këtë:

## **RREGULLORE MBI PUNËN E PËRFAQËSUESES SË KOSOVËS**

### **Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Me rregulloren mbi punën e përfaqësueses së Kosovës përcaktohet mënyra e veprimtarisë, të drejtat dhe obligimet, kushtet e punës së drejtorit, trajnerëve dhe anëtarëve tjerë të ekipit të Përfaqësueses.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e përfaqësueses së Kosovës.

#### **Neni 3 Përfaqësuesja e Kosovës**

1. Me qëllim të përparimit dhe realizimit të arritjeve të rezultateve të larta në pingpong si në arenën vendore apo ndërkombëtare, FPPK-ja formon ekipet e përfaqësueses së Kosovës në pingpong për të gjitha grupmoshat.
2. Udhëheqja e ekipit të Përfaqësueses së Kosovës është në kompetencë të Drejtorit të Përfaqësueses së Kosovës.
3. Në punën profesionale me ekipet e Përfaqësueses angazhohen edhe trajnerët e përfaqësuesve që nominohen nga Drejtori dhe aprovohen nga Bordi Ekzekutiv

### **Kapitulli II Ekipet Përfaqësuese**

#### **Neni 4 Sportistët**

1. Statusin e përfaqësuesit të Kosovës në kategorinë e caktuar e fiton sportisti: - shtetas i Kosovës i regjistruar në FPPK apo me pajtimin e FPPK jashtë shtetit, me kushtin që posedojnë nënshtetësinë e Kosovës dhe i/e cili i pranon vendimet e kësaj Rregulloreje, Statutit dhe akteve të përgjithshme të FPPK. Përzgjedhja bëhet:

- 1.1 me arritjen e kualitetit kulminant në sportin e pingpongut,
- 1.2 duke u bazuar në ranglista zyrtare
- 1.3 në gatishmërinë që në mënyrën më të mirë të përfaqësojë Federatën dhe interesat sportiv të Kosovës.

2. Klubi nga radhët e të cilët është zgjedhur kandidati-reprezentuesi është i obliguar që programin e tij të punës ta harmonizojë me nevojat e reprezentacionit, kandidatit të zgjedhur t'i mundësojë kushte optimale për përparim profesional dhe t'i lejojë pjesëmarrje në të gjitha fazat e aksioneve të reprezentacionit.

3. Kuvendi dhe Bordi Ekzekutiv i FPPK dhe organet e tij janë të obliguar të sigurojnë kushte optimale dhe mundësi materiale për punë të seleksionove të reprezentacioneve të Kosovës.

4. FPPK duhet të sigurojë rekuizita të Përfaqësueses në pjesëmarrje në gara ndërkombëtare nëse ka mundësi.

## **Neni 5**

### **Programi i përfaqësueses**

1. Në kryerjen e programit të përfaqësueses sportisti është i obliguar:
  - 1.1 para fillimit të sezonit në afat prej 8 ditësh pas pranimit të programit të përfaqësueses për vitin e ardhshëm, me shkrim të vërtetojë pranimin e programit, ngase në të kundërtën e humbë statusin e kandidatit për përfaqësuese,
  - 1.2 që në çdo takim reprezentativ të ketë reketin rezervë,
  - 1.3 të përgjigjet në çdo thirrje të drejtorit të përfaqësueses,
  - 1.4 në përgatitje, paraqitje dhe aksione tjera të përfaqësueses të pranojë vendimet e drejtorit, trajnerit apo personit të cilin e ka emëruar Kuvendi për përfaqësues të FPPK,
  - 1.5 me vullnet të kryejë të gjitha detyrat të cilat në përgatitje i parashtron trajneri, -maksimalisht të angazhohet duke shfrytëzuar diturinë e tij, shkathtësitë dhe aftësitë psikofizike me qëllim të arritjes së rezultatit sa më të mirë sportiv, -pranojë vendimet e FPPK se me cilën pajisje dhe me cilat porosi propaganduese do të paraqitet reprezentuesi i Kosovës në takimet ndërkombëtare, -me të gjitha aktivitetet dhe sjelljet e tij të jep kontribut në renomenë e Federatës së tij dhe sportit kosovar në përgjithësi.
2. Pjesëmarrjen në programin e përfaqësueses mundet ta tërheqë vetëm me arsye të dëshmuara dhe të arsyeshme.
  - 2.1. Dorëheqja me arsyetim i dërgohet drejtorit të reprezentacionit.

- 2.2 Për arsyeshmërinë e dorëheqjes vendosë Drejtori i përfaqësueses.
- 2.3 Dorëheqja e paarsyeshme tërheq përgjegjësinë disiplinore apo largim nga përfaqësuesja për një kohë të caktuar.
3. Për mos përmbushje të obligimeve nga Neni 5. i kësaj rregulloreje, Drejtori i përfaqësueses apo personi i caktuar nga ana e Bordit Ekzekutiv apo Kuvendit të FPPK për përfaqësim mund të merr masa disiplinore si në vijim:
- 3.1 largim nga një pjesë e përgatitjeve, -largim nga përgatitjet në tërësi,
- 3.2 largim nga pjesëmarrja në seleksion të reprezentacionit një ndeshje,
- 3.3. largim nga pjesëmarrja në seleksion të reprezentacionit një garë.  
Kur Drejtori i përfaqësueses apo personi i caktuar për përfaqësimin e FPPK aplikon masat disiplinore ndaj një sportisti, ai duhet për këtë masë të lajmërojë Bordin Ekzekutiv.

### **Neni 6 Garat Olimpikë**

1. Që të mund të zgjidhet për pjesëmarrje në Garat Olimpikë, sportisti duhet:
- 1.1 me propozim të Federatës së tij të propozohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës,
  - 1.2 të pranojë rregullat e jo dhunës dhe fair-play-it,
  - 1.3 të mos përdorë cilëndo lloj të substancave të ndaluara nga ITTF dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON),
  - 1.4 të jetë i gatshëm t'i nënshtrohet të gjitha testeve mjekësore, sipas rregullave të Komisionit Mjekësor të KON,
  - 1.5 pranojë që në veshjen apo pajisjen e tij nuk do të ketë asnjë porosi përveç atyre shenjave të aprovuara nga KON,
  - 1.6 të pranojë që për pjesëmarrje në Lojëra Olimpikë të mos kërkojë shpërblim,
  - 1.7 sjelljet e tij dhe vendimet t'i harmonizojë me rregullat e ITTF dhe KON.
2. Kandidati për pjesëmarrje në Lojëra Olimpikë i akuzuar për thyerjen e rregullave të lartpërmendura ka të drejtë të kërkojë diskutim në Komitetin Olimpik të Kosovës, vendimi i të cilit është përfundimtar.

## **Kapitulli III Drejtori i përfaqësueses**

### **Neni 7 Të drejtat dhe detyrat**

1. FPPK-ja e ka Drejtorin e Përfaqësueses së Kosovës të cilin e zgjedh Bordi Ekzekutiv sipas konkursit publik.

- 1.1 Drejtori është i pavarur në punën e tij profesionale, ndërsa për punën dhe përgjegjësitë e tij/saj i përgjigjet Bordit Ekzekutiv dhe i raporton Kuvendit në baza vjetore.
  - 1.2 Drejtori bën përzgjedhjen dhe përbërjen e sportistëve të Përfaqësueses për të gjitha grupmoshat si dhe bën përzgjedhjen dhe përbërjen e trajnerëve të Përfaqësueses duke u bazuar në kriteret meritore dhe profesionale të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Drejtorit të miratuar nga Bordi Ekzekutiv, për të siguruar një paraqitje sa më të suksesshme, etike, profesionale dhe dinjitoze të Përfaqësueses së Kosovës në ngjarjet dhe garat ndërkombëtare.
- 2 Për të gjitha ekipet e përfaqësueses së Kosovës përcaktohen dhe angazhohen trajnerët përkatës.
    - 2.1 Drejtori bën përzgjedhjen e trajnerëve të ekipeve Përfaqësuese bazuar në kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Drejtorit dhe të miratuar nga Bordi Ekzekutiv.
    - 2.2 Trajnerët mund të zgjedhën për secilën garë ndërkombëtare paraprakisht duke u bazuar edhe në faktin se cilin nga sportistët e përfaqësueses së përzgjedhur është i pari në ranglistë apo më i miri i ranguar nga lista e aprovuar nga Bordi dhe tutje me radhë. Në rast të mungesës së atij trajneri, zgjidhet trajneri i sportistit të radhës në ranglistë që është i përzgjedhur.
    - 2.3 Trajnerët për kampe vendor apo ndërkombëtare zgjedhën nga drejtori i përfaqësueses.
    - 2.4 Trajnerët e angazhuar në gara ndërkombëtare, kampe apo aktivitete në të cilët janë përzgjedhur, obligohen deri shtatë ditë pune pas përfundimit të aktivitetit të dërgojnë raport tek Drejtori i Përfaqësueses.
    - 2.5 Trajner nuk mund të jetë sportisti i përfaqësueses.
  - 1.1.1. Për punën e tij, trajneri i ekipit të Përfaqësueses i përgjigjet Drejtorit.
  2. Drejtori me automatizëm është edhe kryetar i Komitetit të Trajnerëve të FPPK-së.
  3. Drejtori, krahas planit profesional të punës një vjeçare dhe katër vjeçare, obligohet të dorëzojë raportin pas secilit përfaqësim ndërkombëtarë si dhe raportin vjetor të punës të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi.

## **Neni 8**

### **Kandidimi dhe mandati i drejtorit**

1. Një person për të kandiduar dhe për t'u emëruar Drejtor i Përfaqësueses së Kosovës duhet të plotësoj kushtet dhe kriteret minimale si në vijim:
  - 1.1 të jetë veprimtar i dalluar sportit të pingpongut me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;

- 1.2 të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike ose
  - 1.3 i certifikuar në njërën nga nivelet formale të ITTF për trajner;
  - 1.4 të njeh një gjuhë botërore, përparësi i jepet gjuhës angleze;
  - 1.5 mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartës Olimpike dhe të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.
2. Drejtori zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të ri-kandidimit dhe përzgjedhjes së serishme.
3. Kompensimi i Drejtorit të Përfaqësueses, trajnerëve dhe sportistëve bëhet përmes linjave buxhetore të miratuara të planifikuara dhe propozuara nga Bordi Ekzekutiv e të aprovuara në Kuvendin e FPPK.

## **Kapitulli IV**

### **Trajnerët e përfaqësueses**

#### **Neni 9**

##### **Punët dhe detyrat e trajnerit**

1. Për të gjitha ekipet e përfaqësueses së Kosovës përcaktohen dhe angazhohen trajnerët përkatës.
2. Për punën e tij, trajneri i ekipit të Përfaqësueses i përgjigjet Drejtorit.
3. Drejtori bën përzgjedhjen e trajnerëve të ekipeve Përfaqësuese bazuar në kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Drejtorit dhe të miratuar nga Bordi Ekzekutiv e që duhet bazuar edhe në ranglistat e FPPK-së ku janë të pasqyruara rezultatet e sportistëve të tyre.

## **Kapitulli V**

### **Dispozitat përfundimtare**

#### **Neni 10**

##### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Reprerentacionet e Kosovës e vitit 2022.

#### **Neni 11**

##### **Aplikimi i dispozitave të Statutit**

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen në pajtim me dispozitat e Statutit të Federatës së Pingpongut.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Federatës së Pingpongut të Kosovës dhe publikimit në faqen zyrtare të FPPK-së.



**Nehat Çitaku**

**Kryetar**